



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1123/ Prot.

Tiranë, më 16.8 2019

VENDIM QARKULLUES Nr. 195, datë 14.08.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 14.08.2019, pasi shqyrtoi Relacionin e DRKK Shkodër me objekt gjetje arkeologjike rastësore, Raportin e vlerësimit mbi një objekt të artit shkëmbor në Përroin e Xhrisë, fshati Xhuxhë, Mirditë, për gatitur nga Rudenc Ruka me kontributin e Agron Islamit dhe Gjergj Gjurajt, si dhe Relacionin e verifikimit në terren realizuar nga ASHA në lidhje me të,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e DRKK Shkodër me objekt gjetje arkeologjike rastësore, Raportin e vlerësimit mbi një objekt të artit shkëmbor në Përroin e Xhrisë, fshati Xhuxhë, Mirditë, për gatitur nga Rudenc Ruka me kontributin e Agron Islamit dhe Gjergj Gjurajt", si dhe Relacionin e verifikimit në terren realizuar nga ASHA në lidhje me të, sipas përcaktimeve të mëposhtme.
2. Ky objekt i artit shkëmbor, për shkak të natyrës së rrallë dhe vlerave që përmban sa i përket trashëgimisë kulturore kombëtare, të depozitohet në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar, me qëllim studimin e mëtejshëm dhe ekspozimin e tij.
3. Ngarkohet DRKK Shkodër, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës, të kryejnë transportimin e objektit në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al